



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelaria Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	02.05.2024
REFERENC-Ë:	23/7409/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Lab-Oil" Sh.p.k. Preoc, Graçanicë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, e ka shqyrtuar kërkesën për Pëlqim Mjedisor të dërguar nga kompania e Juaj me nr.prot.: 23/7409/711/ DMMU, dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur si në vendimin e bashkangjitur të kësaj letërpërcjellëse.

Vendimi për Përfundim të procedurës administrative të kërkesës së Kompanisë "Lab-Oil" Sh.p.k. Preoc, Graçanicë - për Fabrikën e Pet Koksit dhe Impiantin për Deponimin e Koksit, Preoc, Graçanicë.

Me respekt,

Faqe 1 nga 3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General
Secretary*

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181, nxjerr këtë:

V E N D I M

Përfundim të procedurës administrative të kërkesës së kompanisë "Lab-Oil" Sh.p.k. Preoc, Graçanicë, e cila ka aplikuar për Fabrikën e Pet Koksit dhe Impiantin për Deponimin e Koksit në ngastrën kadastrale Nr. P-73414058-00590-3, P-73414058-00591-2, P-73414058-00591-3, P-73414058-00592-10 në Preoc dhe P-73414042-01699-1 në Llapllasellë, Graçanicë.

A r s y e t i m

Gjatë shqyrtimit të kërkesës, Raportit të VNM-së dhe dokumentacionit përcjellës të Kompanisë "Lab-Oil" Sh.p.k. Preoc, Graçanicë, e cila aplikuar për Fabrikën e Pet Koksit dhe Impiantin për Deponimin e Koksit, Preoc, Graçanicë, është konstatuar mungon dokumentacioni si në vijim:

- Mungon Kopja e planit dhe certifikata e pronësisë për ngastrën kadastrale 005390-3

Faqe 2 nga 3

- Duhet të përmirësohet baza ligjore në Raport (të merret parasysh legjislacioni në fuqi)

Bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për VNM, Neni 17, Paragrafi 2, 3 dhe 4, Kompanisë "Lab-Oil" Sh.p.k. Preoc, Graçanicë, me datën 26.12.2023 i është dërguar njoftimi për plotësim të dokumentacionit.

Dokumentet e kërkuara janë sjellë në afatin e përcaktuar ligjor.

Në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-181 për VNM, neni 16, me datën 11.03.2024 është mbajtur debati publik.

Bazuar në procesverbalin e dërguar nga Kompania njoftimi për debat publik nuk është bërë në përputhje me ligjin Nr. 08/L-181 për VNM, neni 16.

Bazuar në të lartcekuat, MMPHI merr vendim për **Përfundimin e Procedurës Administrative** të kërkesës për paisje me Pëlqim Mjedisor për kompaninë "Lab-Oil" Sh.p.k. Preoc, Graçanicë, e cila ka aplikuar për Fabrikën e Pet Koksit dhe Impiantin për Deponimin e Koksit në ngastrën kadastrale Nr. P-73414058-00590-3, P-73414058-00591-2, P-73414058-00591-3, P-73414058-00592-10 në Preoc dhe P-73414042-01699-1 në Llapllasellë, Graçanicë.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për riaplikim sipas procedurës së rregullt.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 23/7409/1- ZSP/ /24 datë: 02.05.2024

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. Komunës së Graçanicës
5. Kabinetit të Ministrisë
6. Divizioni për komunikim me publikun
7. Arkivit të MMPHI

Izedin Bytyqi
Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm
të MMPHI



Faqe 3 nga 3